

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 79, datë 2.2.2011

P Ë R

**KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE NDËRMJET FEDERATËS  
SHQIPTARE TË FUTBOLLIT DHE MINISTRISË SË TURIZMIT,  
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, ME QËLLIM RINDËRTIMIN,  
MODERNIZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E STADIUMIT KOMBËTAR  
"QEMAL STAFI"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave


V E N D O S I:

1. Dhënien e pëlqimit për krijimin e një shoqërie anonime aksionare, me qëllim rindërtimin, modernizimin dhe administrimin e stadiumit kombëtar "Qemal Stafa", me kusht ndalimin e ndryshimit të destinacionit, si objekt sportiv.
2. Aksionarët e kësaj shoqërie anonime të jenë shteti, i përfaqësuar nga ministria përgjegjëse për sportin, dhe Federata Shqiptare e Futbollit.
3. Raporti i aksioneve në krijimin e shoqërisë anonime, të re, të jetë:
  - 25% shteti, i përfaqësuar nga ministria përgjegjëse për sportin;
  - 75% Federata Shqiptare e Futbollit.
4. Krijimi i shoqërisë anonime do të jetë pa afat.

5. Emërtimi i shoqërisë të vendoset në aktin e themelimit me marrëveshje, ndërmjet aksionarëve.
6. Autorizohet ministria përgjegjëse për sportin, në zbatim të këtij vendimi, për themelimin dhe krijimin e shoqërisë anonime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
7. Pas përfundimit të procedurave ligjore në fuqi për administrimin e pasurive të shoqërive anonime me aksionar të vetëm shtetin, kalimi i stadiumit kombëtar "Qemal Stafa" në kapitalin e shoqërisë anonime të bëhet pa asnjë barrë apo detyrim ndaj të tretëve.
8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për kryerjen e procedurave për kalimin e stadiumit kombëtar "Qemal Stafa" në kapitalin e shoqërisë aksionare, që krijohet sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".


KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS,  
RINISË DHE SPORTEVE


FERDINAND XHAFERRI



NR. PROT. 390/V  
DATË 18.3.2011

PRESIDENCË  
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË  
DHE SPORTEVE  
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE  
ENERGJETIKËS  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT  
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE





Tiranë, më 25/03/2011

## VENDIM

Nr 14, datë 25.03.2011

**Miratimi i krijimit të Shoqërisë Aksionere ndërmjet Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Turizmit, Kultures, Rinisë dhe Sporteve, me qëllim rindertimin, modernizimin dhe administrimin e Stadiumit Kombëtar "Qemal Stafa"**

Komiteti Ekzekutiv i FSHF-se në mbledhjen e tij të datës 25.03.2011, pasi u njoh Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 79, datë 02.02.2011:

### VENDOSI:

1. Krijimin e Shoqërisë Anonime Aksionere ndërmjet Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Turizmit, Kultures, Rinisë dhe Sporteve, me qëllim rindertimin, modernizimin dhe administrimin e Stadiumit Kombëtar "Qemal Stafa".
2. Aksioneret e kësaj shoqërie anonime do të jenë shteti, i përfaqësuar nga Ministria përgjegjëse për sportin dhe Federata Shqiptare e Futbollit.
3. Raporti i aksioneve në krijimin e shoqërisë së re anonime, të jetë :
  - 75% Federata Shqiptare e Futbollit
  - 25% Ministria përgjegjëse për sportin
4. Keshilli i parë i Administrimit të Shoqërisë Aksionere do të përbehet nga 5 (pese) anetar me mandat 3 (tre) vjeçar me të drejte perseritje. FSHF do të përfaqësohet nga:
 

I.	Armand Duka	President FSHF
II.	Eduard Prodani	Sekretar i Përgjithshëm FSHF
III.	Skender Hyka	Anetar i Komitetit Ekzekutiv FSHF
IV.	Besnik Cela	Zv/Sekretar i Përgjithshëm FSHF
5. Administratori i parë i shoqërisë emerohet Z. Ardian Cani, person madhor e me zotësi të plote për të vepruar, i cili ka një mandat 3 (tre) vjeçar me të drejte perseritje
6. Të miratoje emrin « Qendra Sportive Kug e Zi » sh.a, për shoqërinë e re aksionere.



ALBA TRANE

EUROSIC

LEGEA

plus

DIGITALB

ama  
corporation & dev. s.p.a.

UNION  
BANK



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT  
FOOTBALL ASSOCIATION OF ALBANIA

Rruga "Elbasan" Pn. Shkollë e Gjithësh në Rreth Tiranë ALBANIA  
Tel: ++355 42 446003/42 346764 Fax: ++355 42 346609; E-mail: fshf@fshf.org.al, www.fshf.org

7. Miratimin e Statutit të shoqërisë aksionere "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a.
8. Ngarkohen Presidenti i FSHF Z. Armand Duka dhe Sekretari i Përgjithshëm Z. Eduard Prodani për të përfaqësuar FSHF në procesin e firmosjes së aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë së re.
9. Miratimin e fondit të kapitalit fillestar prej 1.500.000 leke (një milion e pesëqind mijë) leke i cili duhet të depozitohet në numrin e llogarisë në emër të shoqërisë aksionere "Qendra Sportive Kuq e Zi".
10. Bashkelidhur këtij vendimi, Vendimi i Keshillit të Ministrave, Nr. 79, datë 02.02.011si dhe Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë.
11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**P R E S I D E N T I**

**Armand DUKA**

*Armand Duka*



ALBA TRANS

EUROBIO

LEGEA

plus

DIGITALB

amta  
Koleksi 100 e Shkollës

UNION  
BANK

NR. 2050/1 prot  
23/03/2011



## AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I

### SHOQËRISË AKSIONARE

“QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI” SH.A.



# INDEKSI

HYRJE.....	1
TITULLI I.....	5
Përkufizime, Emërtimi, Objekti, Kohëzgjatja, Selia, Ëëbsite.....	5
NENI 2.....	7
Emërtimi.....	7
1. Aksionerët e shoqërisë të përmendur në hyrje të këtij Akt Themelimi dhe Statuti, në bazë të vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 79, datë 02/02/2011, kanë vendosur themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë aksionare të emërtuar.....	7
NENI 3.....	7
Objekti i Shoqërisë.....	7
NENI 4.....	8
Kohëzgjatja.....	8
NENI 5.....	8
Selia, website dhe adresa elektronike, Pronësia Intelektuale.....	8
TITULLI II.....	8
Kapitali i Regjistruar, Kontributet, Aksionet, Aksionarët.....	8
NENI 6.....	8
Kapitali i Regjistruar, Themeluesit.....	8
NENI 7.....	8
Aksionarët, Aksionet, Kontributet,.....	8
TITULLI III.....	9
Veprime me Kapitalin, me Aksionet, Regjistri i Aksioneve.....	9
NENI 8.....	9
Zmadhimi i Kapitalit.....	9
NENI 9.....	10
Njoftimi i Zmadhimit, Regjistrimi i Realizimit të Zmadhimit të Kapitalit.....	10
NENI 10.....	10
Akti i Emetimit të Aksioneve.....	10
NENI 11.....	11
Zvogëlimi i Kapitalit.....	11
NENI 12.....	12
Blerja e Aksioneve nga Shoqëria.....	12
NENI 13.....	12
Vënia në vonesë.....	12
NENI 14.....	13
Anulimi dhe Likuidimi i Aksioneve.....	13
NENI 15.....	13
Kalimi i Aksioneve.....	13
NENI 16.....	14
Regjistri i Aksioneve.....	14
TITULLI IV.....	14
Asambleja e Përgjithshme.....	14
NENI 17.....	14
Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme.....	14
NENI 18.....	15
Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.....	15
NENI 19.....	16



Votat e Aksionarëve.....	16
NENI 20 .....	17
Përfaqësimi në Asamble .....	17
TITULLI V.....	17
Administrimi i Shoqërisë .....	17
NENI 21 .....	17
Emërimi, Shkarkimi i Këshillit të Administrimit, Kompetencat.....	17
NENI 22 .....	18
Administratori.....	18
NENI 23 .....	18
Shpërblimi .....	18
NENI 24 .....	18
Ekspertët Kontabël, emërimi dhe shpërblimi .....	18
TITULLI VI.....	19
Dividendët dhe Rezervat .....	19
NENI 25 .....	19
Dividendët .....	19
NENI 26 .....	19
Rezervat.....	19
TITULLI VII .....	19
Neni 27 .....	19
Rregulloret, Komitetet dhe Marrëveshjet midis Aksionarëve .....	19
TITULLI VIII.....	20
Prishja dhe Likuidimi.....	20
NENI 28 .....	20
Prishja dhe Likuidimi .....	20
TITULLI XI.....	20
ANEKSI I.....	22
(Themeluesit/Aksionet e nënshkruara/Kontributet).....	22
(Anëtarët e Parë të Këshillit të Administrimit).....	23
ANEKSI III .....	25
(Administrator).....	25
ANEKSI III .....	26
(Auditorët e Parë).....	26







AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQËRISË AKSIONARE

QENDRA SPORTIVE

"....." SH.A

K.U.O. E ZI

HYRJE

Sot, në Tiranë, më datë 26/03/2011, Themeluesit:

1 **Organizata Jofitimprurëse "Federata Shqiptare e Futbollit"**, regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 9, datë 31/07/2001, me numër NIPT 62008031, me seli në Tiranë në adresën rruga "Elbasanit", përfaqësuar nga përfaqësuesit ligjor: Presidenti Armando Duka, i biri Enver, lindur në SHIJAK, më datë 07/10/1962, me adresë Rr. Xhamat Kuska, Durrës, identifikuar me letërnjoftim elektronik 519371659 dhe Sekretari i Përgjithshëm Eduart Prodani, i biri Luani, lindur në TIRANË, më datë 18/06/1963, me adresë Rr Komuna Parisit, Tiranë identifikuar me letërnjoftim elektronik 025863670.

Dhe,

2 **Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve**, institucion publik, me numër NIPT L \_\_\_\_\_, me seli në Tiranë në adresën Rruga "Durrësit", nr. \_\_\_\_, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor zoti Ferdinand Xhaferaj, i biri i Mynyrut, lindur në Durrës më datë 23.01.1964, me adresë rruga e Kavajës, Tiranë, identifikuar me pasaportën me nr. D 0000409

Duke marrë në konsideratë faktin se ndërtimi dhe mirëmbajtja e një stadiumi të ri përbën një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në kuadër të politikave të saj për zhvillimin, zgjerimin dhe forcimin e kulturës sportive dhe rritjen e konkurrencës sportive;

Duke marrë në konsideratë faktin se Federata Shqiptare e Futbollit ka për qëllim të saj in promovimin e sportit të futbollit, bashkëpunimin me klubet sportive të futbollit dhe organizimin e ndeshjeve të futbollit dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive në mjedise të përshtatshme e moderne,

Duke qenë se themeluesit konsiderojnë të nevojshme ndërtimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e një stadiumi të ri, i cili plotëson kushtet për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare, sipas standardeve të vendosura nga UEFA dhe FIFA dhe njëkohësisht rrit kapacitet pjesëmarrëse të dashamirësve të sportit të futbollit,

Në kuadër të frymës së bashkëpunimit që ekziston ndërmjet themeluesve, Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nga njëra anë dhe Federata Shqiptare e Futbollit nga ana tjetër, për arritjen e qëllimeve të përbashkëta në fushën e zhvillimit dhe modernizimit të sportit shqiptar të futbollit, ngritjen e nivelit të futbollit shqiptar në arenën ndërkombëtare,

Dhe

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 79, datë 02.02.2011, "Për krijimin e Shoqërisë Aksionare ndërmjet Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me qëllim rindërtimin, modernizimin dhe administrimin e Stadiumit Kombëtar "Qemal Stafa"

Themeluesit vendosën të themelojnë dhe regjistrojnë në formën e shoqërisë anonime, Shoqërinë Tregtare :

## **"Qendra Sportive Kuq e Zi" SH.A**

### **TITULLI I**

**Përkufizime, Emërtimi, Objekti, Kohëzgjatja, Selia, website**

### **NENI 1**

#### **Përkufizime**

Në këtë dokument, nëse nuk përcaktohet ndryshe, termit e mëposhtme kanë këto kuptime:

- "Ligji Tregtar":** Ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- "Statuti"** Ky akt themelimi dhe statut i shoqërisë Aksionare "Qendra Sportive Kuq e Zi" Sh.a;
- "Shoqëria"** "Qendra Sportive Kuq e Zi" Sh.a, e themeluar si një shoqëri aksionare (Sh.a) sipas legjislacionit shqiptar;
- "Themelues"** Personat e përcaktuar në nenin 1 (1) të këtij Statuti;
- "Aksionar(ët)"** Sipas rastit, personat fizik ose juridikë që zotërojnë aksionet e Shoqërisë në përputhje me kërkesat e nenit 5, 6 dhe 14 të këtij Statuti;
- "Vendim i Zakonshëm"** Vendimi i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të Aksionarëve pjesëmarrës sipas kërkesave të neneve 145 (2) të Ligjit Tregtar;
- "Vendim i Jashtëzakonshëm"** Vendimi i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me tre të katërtat e votave të Aksionarëve pjesëmarrës në votim sipas kërkesave të nenit 145 (1) të Ligjit Tregtar;
- "Person"** Çdo person fizik apo juridik;
- "Trashëgimtar"** personi që sipas ligjit, është trashëgimtar universal i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të Aksionarit apo ka të drejte në lidhje me zotërimin dhe/ose përfitimin e çdo të drejte ligjore mbi pasuritë e Aksionarit si pasojë e vdekjes së tij, transformimit, prishjes së shoqërisë, falimentimit/likuidimit dhe çdo mjeti tjetër ligjor;
- "Eëbsite"** Hapësira zyrtare e internetit të Shoqërisë;
- "Ditë të plota"** Në lidhje me llogaritjen e afateve, është periudha kohore e përbërë nga ditë punë bankare sipas deklarimeve të Bankës së



**"Statuti i Bllokuar"**

**"Kontroll"**

Shqipërisë, që nis nga dita vijuese e datës kur njoftimi është marrë ose konsiderohet i marrë.

Një afat kohor, i cili nis në datën e nënshkrimit të këtij Statuti, dhe përfundon në datën kur Shoqëria nis veprimet tregtare në përputhje me licencat e marra.

**"Shoqëri e Kontrolluar"**

Një marrëdhënie juridike apo faktike ku një Person zotëron ose kontrollon, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë shumicën e aksioneve apo të votave të një shoqërie, sipas kuptimit të .

**"Unanimitet" ose "Vendim Unanim"**

Është shoqëria tregtare me zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë apo jashtë shtetit, e cila kontrollohet nga Shoqëria apo persona të autorizuar prej saj.

Martja e vendimeve me miratimin e të gjithë aksionarëve të Shoqërisë.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Aksionarëve në adresat e regjistruara në Regjistrin e Aksioneve të Shoqërisë sipas nenit 15 të këtij Statuti, në bazë të deklarimeve që Aksionarët i bëjnë Këshillit të Administrimit të Shoqërisë.

Të gjitha njoftimet zyrtare, kërkesat, ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti, do të konsiderohen të kryera rregullisht në adresat e Aksionarëve kur njoftimi, kërkesa apo komunikimi është: (i) dërguar personalisht, (ii) dërguar me poste rekomande ose me kthim përgjigje, ose i është (iii) dorëzuar një shoqërie ndërkombëtare të mirënjohur të shërbimit të shpejtë postar, në adresën e regjistruar në Regjistrin e Aksioneve të Shoqërisë.

Të gjitha njoftimet zyrtare, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti, do të konsiderohen të marra në mënyrë të rregullt nga Aksionari në datën më të hershme, ndërmjet: (i) datës së marrjes efektive ose refuzimit të pranimit nga ana e Aksionarit marrës ose (ii) datës së njoftimit të kthimit nga shërbimi postar, ose datës së depozitimit të njoftimit për llogari të Aksionarit marrës, në zyrën vendore të shoqërisë përkatëse ndërkombëtare të mirënjohur të shërbimit të shpejtë postar.

Të gjitha njoftimet zyrtare, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti mund të kryhen me mjete elektronike. Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas legjislacionit mbi nënshkrimin elektronik dhe u dërgohen Aksionarëve në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

Në kuptim të këtij Statuti, shprehjet në numrin njëjës përfshijnë ato në numrin shumës dhe anasjelltas, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës përkatëse rezultojnë ndryshe. Përemri vetor "ai" përfshin edhe përemrin vetor "ajo" dhe përemri

vektor "ata" i nënkupton të dyja gjinitë, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës përkatëse rezultojnë ndryshe.

## NENI 2 Emërtimi

Aksionarët e shoqërisë të përmendur në hyrje të këtij Akt Themelimi dhe Statuti, në bazë të vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 79, datë 02.02.2011, "Për Krijimin e Shoqërisë Aksionare ndërmjet Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me qëllim rindërtimin, modernizimin dhe administrimin e Stadiumit Kombëtar "Qemal Stafa", kanë vendosur themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë aksionare të emërtuar:

### "Qendra Sportive Kuq e Zi" SH.A

2. Në çdo dokument, shkresë, apo komunikim tjetër që do të lëshohet nga shoqëria duhet të shënohet emërtimi i plotë i saj.

## NENI 3 Objekti i Shoqërisë

- (1) Shoqëria ka si objekt kryesor zhvillimin e aktiviteteve të mëposhtme:  
Rindërtimin, modernizimin dhe administrimin, e stadiumit kombëtar "Qemal Stafa" me kusht ndalimin e ndryshimit të destinacionit..
- (2) Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e çdo shërbimi tjetër dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor.
- (3) Shoqëria mund të marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthortë në çdo shoqëri që ka të objekt të ngjashëm apo që lidhet me objektin e Shoqërisë. Për këtë qëllim, shoqëria mund të bashkëpunojë me, ose në çdo mënyrë tjetër, të drejtpërdrejtë ose tërthortë, të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm ose që kanë lidhje me objektin e shoqërisë ose ndihmës për realizimin e objektit të shoqërisë. Shoqëria për të garantuar detyrimet e veta dhe ato të palëve të treta mund të vendosë garanci, si peng ose barrë hipotekore, përfshirë aktivitetin e saj. Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet ekonomik, financiar, veprime me pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, pjesërisht ose plotësisht, çdo tregti ose aktivitet tregtar dhe të zhvillojë çdo tregti ose aktivitet tjetër fitimprurës i cili mund të jetë mund të jetë dobiprurës në lidhje me aktivitetet tregtare të shoqërisë.

- (4) Shoqëria mund të angazhohet gjithashtu në çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk ndalohet me ligj.

#### **NENI 4 Kohëzgjatja**

- (1) Shoqëria themelohet për të ushtruar aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

#### **NENI 5 Selia, website dhe adresa elektronike, Pronësia Intelektuale**

- (1) Shoqëria do të ketë selinë e saj fillestare për qëllime të regjistrimit në adresën e Federatës Shqiptare të Futbollit.
- (2) Shoqëria do të ketë website-in e saj zyrtar i cili do të vendoset nga Këshilli Mbikëqyrës brenda 30 ditëve nga themelimit të shoqërisë.
- (3) Shoqëria do të ketë adresat e saj zyrtare për komunikimet elektronike sipas pikës 2 më sipër.
- (4) Shenjat dalluese të aktivitetit ekonomik, të adresave elektronike dhe të website mund të njohohen vullnetarisht në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (5) Markat tregtare/patentat dhe pronësitë e tjera intelektuale të Shoqërisë mund të regjistrohen në përputhje me legjislacionin mbi pronësinë intelektuale dhe industriale në fuqi.

#### **TITULLI II Kapitali i Regjistruar, Kontributet, Aksionet, Aksionarët**

#### **NENI 6 Kapitali i Regjistruar, Themeluesit**

- (1) Kapitali i regjistruar i Shoqërisë, është 2.000.000 leke (dy-milion-) Lekë, i cili ndahet në 2.000 (dy-mijë) aksione të zakonshme, me vlerë nominale 1.000 (një-mijë) Lekë secila. Aksionet e Shoqërisë nënshkruhen e paguhen në para nga Themeluesit, siç përcaktohet në Aneksin i bashkëngjitur këtij Statuti si pjesë përbërëse e tij.

#### **NENI 7 Aksionarët, Aksionet, Kontributet,**

- (1) Aksionarët e Shoqërisë do të jenë personat të cilët kanë fituar aksionet e tyre në mënyrat e përcaktuara nga Ligji Tregtar dhe dispozitat e këtij Statuti. Ndarja e aksioneve



bëhet duke respektuar Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 79, datë 02.02.2011, "Për Krijimin e Shoqërisë Aksionare ndërmjet Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me qëllim rindërtimin, modernizimin dhe administrimin e Stadiumit Kombëtar "Qemal Stafa, duke vlerësuar se shoqëria aksionare do të ketë aksionarë që përfaqësojnë ortakun shtet.

(2) Aksionet e Shoqërisë janë të zakonshme. Çdo aksion do të ketë të njëjtën vlerë nominale. Kriteret e vlerësimit dhe procedurat për shndërrimin e aksioneve nga një klasë në tjetrën, si dhe për shndërrimin e obligacioneve e titujve të tjerë, vendosen nga Asambleja e Aksionarëve me të njëjtën shumicë të kërkuar nga Ligji Tregtar për ndryshimin e Statutit.

(3) Aksionet që do të emetohen sipas vlerave të kapitalit themeltar përcaktuar në këtë Statutit, apo sipas zmadhimit të kapitalit miratuar nga Asambleja e Aksionarëve, duhet të nënshkruhen nga Aksionarët jo më vonë se 15 Ditë të Plota nga dita e miratimit të vendimit (apo e nënshkrimit të Statutit), apo në rastet kur kjo kërkohet me Ligj, nga dita e miratimit të prospektit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Aksionari që brenda këtij afati, pa arsye të justifikuar, nuk kryhen nënshkrimin aksioneve të reja që do të emetohen, konsiderohet se ka hequr dorë nga të drejtat e parablerjes sipas nenit 7 të këtij Statuti. Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë afate të ndryshme me miratimin e zmadhimit të kapitalit.

(4) Aksionet e nënshkruara janë me kontribut në para dhe do të shlyhen në një të katërtën e vlerës së tyre nominale përpara regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shumat që mbeten shlyhen regjistrimit të shoqërisë, brenda afateve të Ligjit Tregtar dhe vendimit të Asamblesë së Aksionarëve.

(5) Në rast zmadhimi të kapitalit të shoqërisë, primet mbi aksionet e nënshkruara me kontribut në para duhet të shlyhen tërësisht përpara regjistrimit të realizimit të zmadhimit të kapitalit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

### TITULLI III

#### Veprime me Kapitalin, me Aksionet, Regjistri i Aksioneve

#### NENI 8

#### Zmadhimi i Kapitalit

(1) Asambleja e Aksionarëve, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm, mund të zmadhojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.

(2) Secili Aksionar ekzistues, proporcionalisht me totalin e aksioneve të zotëruara, do të ketë të drejtën të nënshkruajnë Aksionet që do të emetohen si pasojë e zmadhimit, duke u preferuar ndaj çdo të treti. Kjo e drejtë mund të kufizohet në bazë të një vendimi të Asamblesë së Aksionarëve sipas kërkesave të nenit 174(2) të Ligjit Tregtar.

(3) Asambleja e Aksionarëve, me miratimin unanimit, mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues.

(4) Zmadhimi i kapitalit konsiderohet i realizuar pas përfundimit të afatit të caktuar për nënshkrimin e aksioneve, përcaktuar në Statut ose sipas vendimit të Asamblesë së Aksionarëve . Në rast se aksionet nuk nënshkruhet brenda afatit të përcaktuar në Statut

apo sipas vendimit përkatës të Asamblesë së Aksionarëve, atëherë asambleja mund të shtyjë afatin vetëm për 15 ditë të tjera. Në rast se dështon nënshkrimi i aksioneve të emetuara në një operacion zmadhimi kapitalit, atëherë ky operacion do të konsiderohet null dhe pa efekte. Vetëm pas nënshkrimit në tërësi të aksioneve të emetuara në rast zmadhimi, mund të procedohet me regjistrimin e zmadhimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(5) Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin edhe sipas mënyrave, kushteve e procedurave të tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar, të ndryshme nga sa parashikon ky nen. Në këto raste, dispozitat e këtij Statuti janë të zbatueshme për sa është e mundur, në lidhje me zmadhimin e kapitalit sipas mënyrave, kushteve e procedurave të tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar. Në këto raste zmadhimi janë të zbatueshme dispozitat përkatëse të Ligjit Tregtar. Në rastin e zmadhimit të kapitalit me kontribut në natyrë, duhet që ky kontribut të kalojë në shoqëri në momentin e regjistrimit të zmadhimit të kapitalit.

## NENI 9

### Njoftimi i Zmadhimit, Regjistrimi i Realizimit të Zmadhimit të Kapitalit

(1) Shoqëria njofton pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin e për zmadhimin e kapitalit sipas afateve e kërkesave të Ligjit për QKR.

(2) Vendimi Asamblesë së Aksionarëve për zmadhimin e kapitalit publikohet edhe në faqen e internetit të Shoqërisë, e në rastet kur kërkohet nga Ligji për Titujt, vendimi i njoftohet gjithashtu për miratim Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, së bashku me Prospektin e përgatitur për këtë qëllim (për rastet kur hartimi i prospektit është i detyrueshëm).

(3) Regjistrimi i zmadhimit të kapitalit kryhet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit .

(4) Me përfundimin e nënshkrimit të aksioneve sipas afateve të kërkuara, Shoqëria regjistron në QKR Realizimin e Zmadhimit, dhe depoziton listën e plotë të personave që kanë nënshkruar aksionet, së bashku me shumat e parapaguara, dhe/ose sipas rastit, aktet e vlerësimit të kontributeve në natyrë, kur aksionet janë nënshkruar me kontribute në natyrë. Nëse zmadhimi realizohet brenda afateve të kërkuara për njoftimin pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të vendimit që miraton zmadhimin sipas paragrafit 1 më sipër, atëherë Shoqëria njëkohësisht njofton vendimin dhe regjistron Realizimin e Zmadhimit të kapitalit.

(5) Regjistrimi i Realizimit të Zmadhimit të kapitalit i nënshtrohet gjithashtu kushteve të tjera të përcaktuara nga Ligji Tregtar për zmadhimin e kapitalit në raste të veçanta.

(6) Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të Realizimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

## NENI 10

### Akti i Emetimit të Aksioneve

(1) Aksionet emetohen nëpërmjet Aktit të Emetimit të Aksioneve që miratohet nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë brenda 30 ditëve nga regjistrimi apo marrja e vendimit për zmadhimin -, sipas rastit pas regjistrimit të shoqërisë, apo pasi zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv. Aksionet e reja nuk mund të emetohen, dhe aksionet e të drejtat e

lidhura me to nuk mund të transferohen përpara se zmadhimi i kapitalit të bëhet efektiv e të miratohet Akti të Emetimit të Aksioneve.

(2) Akti i Emetimit të Aksioneve përmban të dhënat e mëposhtme:

- Emërtimin dhe Zyrën Qendrore të Shoqërisë;
- Numrin dhe Datën e vendimit për zmadhimin e kapitalit;
- Numrin dhe Datën e vendimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mbi miratimin prospektusit (në rastet kur ky miratim kërkohet me Ligj) apo një shënim që miratimi konsiderohet i dhënë sipas Ligjit për Titujt, ose që ky miratim nuk kërkohet nga Ligji për rastin konkret.
- Datën kur Zmadhimi i Kapitalit është bërë efektiv nëpërmjet regjistrimit të Realizimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Vlerën Totale të Emetimit (Vlerën totale të zmadhimit të kapitalit që është nënshkruar e realizuar);
- Vlerën totale dhe për aksion të primeve të emetimit, nëse ka;
- Klasën e aksioneve të emetuar dhe të drejtat që u jepen aksionarëve (përparësitë) nëse ka;
- Numrin Total të Aksioneve të emetuara;
- Vlerën Nominale të Aksioneve të Emetuara;
- Shumën totale të shlyer përpara emetimit;
- Përqindjen totale të shlyer përpara emetimit;
- Qëllimin e përdorimit të fondeve;
- Afatet e shlyerjes së pjesës së mbetur të vlerës nominale të aksionit;
- Përqindjen që zë emetimi i aksioneve në kapitalin total pas emetimit;
- Mundësitë e konvertimit në klasa të ndryshme aksionesh, nëse ka;

(4) Akti të Emetimit të Aksioneve i bashkëngjitet lista e plotë e personave që kanë nënshkruar aksionet.

(5) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në vendimin që miraton zmadhimin, aksionet e reja marrin pjesë në fitimet e të gjithë vitit financiar, në të cilin është marrë vendimi. Vendimi mund të parashikojë, që aksionet e reja të marrin pjesë nga fitimet e vitit paraardhës financiar.

## NENI 11

### Zvogëlimi i Kapitalit

(1) Asambleja e Aksionarëve, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.

(2) Në rastet kur zvogëlimi i kapitalit nuk kryhet për shkak të humbjeve të aktivitetit tregtar, Asambleja e Aksionarëve mund të vendosë të anulohet një a më shumë aksione në përputhje me Nenin 14 të këtij Statuti, si dhe të dispozitave të Ligjit Tregtar, e në veçanti të nenit 186 të këtij ligji.

(3) Zvogëlimi i kapitalit regjistrohet e publikohet pa vonesa pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Kapitali quhet i zvogëluar, duke filluar nga çasti i regjistrimit të vendimit.

(4) Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara nga Ligji Tregtar, vetëm në rastin kur zvogëlimi shfaqet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.



**NENI 12**  
**Blerja e Aksioneve nga Shoqëria**

(1) Shoqëria nuk mund të blejë Aksionet e saj.

**NENI 13**  
**Vënia në vonesë**

(1) Në përputhje me kushtet për shlyerjen e kontributeve të nënshkruara sipas parashikimeve të nenit 6 të këtij Statuti, Këshilli i Administrimit do të njoftojë Aksionarët për pagesën e pjesës së mbetur të kontributeve në para, ende të pashlyera në lidhje me Aksionet e nënshkruara prej tyre, duke përcaktuar vendin se ku duhet të kryhet shlyerja, dhe çdo Aksionar, jo më vonë se katërmëdhjetë Ditë të Plota pas marrjes së këtij njoftimi do t'i paguajë Shoqërisë shumën e pashlyer. Kontributi i pashlyer mund të kërkohej të paguhet me këste.

(2) Aksionari të cilit i drejtohet njoftimi për shlyerje është përgjegjës në mënyrë solidare me personin të cilit i ka/i është kaluar Aksioni i pashlyer, pavarësisht nëse Aksioni është kaluar përpara apo pas kërkesës për shlyerje.

(3) Nëse kontributet e pashlyera nuk paguhen brenda afatit të kërkuar, atëherë Aksionari konsiderohet në vonesë, dhe detyrohet t'i paguajë Shoqërisë një interes mbi shumën e pashlyer duke filluar nga dita kur kjo shume duhet të ishte shlyer (si më sipër) e deri në momentin e shlyerjes efektive, me një normë interesi vjetor prej 4%.

(4) Nëse kontributi mbetet i papaguar pavarësisht vënies në vonesë, Këshilli i Administrimit me anë të një njoftimi të dytë, mund t'i japë Aksionarit që duhet të shlyejë kontributin një afat të mëtejshëm prej jo me pak se tridhjetë Ditë të Plota, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer bashkë me interesin që mund të jetë akumuluar. Njoftimi përmban kohën dhe vendin ku duhet të kryhet pagesa. Aksionari që nuk ka shlyer kontributin në vendin dhe brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e dytë, deri në shlyerjen e plotë të kontributit të pashlyer, humbet të drejtën e pjesëmarrjes dhe të votës në Asamblesë e Aksionarëve, dhe të gjitha aksionet e zotëruara prej tij nuk llogariten për arritjen e kuorumit. Aksionari gjithashtu humbet të drejtën për të përfituar dividend si dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga Aksionet e pashlyera.

(5) Nëse kontributi i pashlyer nuk paguhet brenda 3 muajsh nga përlundimi i afatit të caktuar në njoftimin e dytë sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni, Shoqëria, pa çenuar të drejtën të kërkojë dëmshpërblim shtesë të shkaktuar nga vonesa në shlyerjen e kontributit nëpërmjet një vendimi të Këshilli i Administrimit mund:

- a) T'i ofrojë Aksionet e pashlyera Aksionarëve të tjerë, në përpjesëtim me Aksionet e zotëruara prej tyre në Shoqëri; ose
- b) Nëse Aksionarët e tjerë nuk pranojnë nënshkrimin e kuotës së pashlyer, t'i propozojë Asamblesë së Aksionarëve të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me shumën e pashlyer në përputhje me nenin 14 më poshtë.

(6) Në rast se Shoqëria i ofron Aksionet e pashlyera Aksionarëve të tjerë, nënshkrimi dhe shlyerja e tyre duhet të kryhet brenda 15 ditëve nga dita e miratimit të vendimit të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni. Këshilli i Administrimit, menjëherë mbas

nënshkrimit dhe shlyerjes si më sipër, regjistron kryesisht kalimin e aksioneve tek aksionarët e tjerë që i kanë nënshkruar e shlyer ato. Këshilli i Administrimit mund të vendosë që nënshkrimi e shlyerja nga Aksionarët e tjerë të kryhet duke paguar prime emetimi.

(7) Në rastet e parashikuara nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, Aksionari që nuk shleu kontributet, nuk do të ketë të drejtë t'i kërkojë Shoqërisë kthimin e shumave të parapaguara prej tij në lidhje me Aksionin e pashlyer, por mund të kompensojë shumat e parapaguara me demin që mund t'i kërkojë Shoqëria si pasojë e mos shlyerjes së kontributit. Shumat e parapaguara në lidhje me Aksionin e pashlyer do të pasqyrohen në pasqyrat financiare, sipas rastit, si kontribut ndërmjet Aksionarëve që i kanë nënshkruar e shlyer ato, ose në rast anulimi, midis të gjithë aksionarëve të tjerë ekzistues, në përpjesëtim me Aksionet e zotëruara prej tyre në Shoqëri.

#### NENI 14

##### Anulimi dhe Likuidimi i Aksioneve

(1) Këshilli i Administrimit, në bazë të vendimeve sipas nenit 11(2) të këtij Statuti, mund të autorizohet të anulojë dhe likuidojë një ose disa Aksione. Anulimi dhe likuidimi i Aksioneve lejohet vetëm në rastet e parashikuara në nenin 11(1) dhe 13 të Statutit apo kur Shoqëria arrin një marrëveshje me Aksionarin që e zotëron aksionin.

(2) Anulimi dhe likuidimi do të kryhet nga Këshilli i Administrimit, në përputhje kërkesat e Statutit dhe të vendimit të Asamblesë së Aksionarëve, duke mbajtur parasysh kriteret e nenit 183 dhe 186 të Ligjit Tregtar.

#### NENI 15

##### Kalimi i Aksioneve

1 Aksionet e Shoqërisë transferohen -sipas mënyrave të përcaktuara në Ligjin Tregtar dhe këtë statut.

2 Në rastin e transferimit të aksioneve, aksionarët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes, e cila do të ushtrohet sipas modaliteteve të përcaktuara në këtë nen. Në rastet e tjera të kalimit të aksioneve është i nevojshëm miratimi nga ana e Asamblesë së Aksionareve .

3. Aksionari i cili kërkon të shesë aksionet e tij do të bëjë njoftim pranë shoqërisë, i cili duhet të përmbajë emrin e aksionarit që do të shesë aksionet, numrin e aksioneve që do të shiten dhe vlerën nominale të tyre. Këshilli i Administrimit pas marrjes së këtij njoftimi duhet të lajmërojë brenda 7 ditëve aksionarët për ushtrimin e të drejtës së parablerjes. Aksionarët duhet të përgjigjen në lidhje me ushtrimin e të drejtës së parablerjes 30 ditë nga marrja e lajmërimit. Nëse e drejta e parablerjes ushtrohet nga të gjithë aksionarët e shoqërisë, aksionet që shiten ndahen tek këta në mënyrë proporcionale me aksionet e zotëruara në shoqëri. Nëse njëri prej aksionerëve nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën e parablerjes, pjesa e tij ju kalon aksionarëve të tjerë në mënyrë proporcionale.

4. Shitja e aksioneve me të drejtë parablerje do të bëhet me vlerën e tyre nominale në momentin që do të bëhet transferimi i aksioneve nga shitësi tek blerësi.

5. Në rast se asnjë prej aksionarëve nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes, Këshilli i Administrimit njofton Aksionarin që kërkon të shesë aksionet dhe i propozon njëkohësisht personin e tretë të interesuar për blerjen e tyre. Aksionari ka të drejtë të propozojë vetë një blerës, i cili sipas 2 të këtij neni, duhet të miratohet nga organi kompetent i shoqërisë.

## NENI 16 Regjistri i Aksioneve

(1) Menjëherë pas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar e miratimit të Aktit të parë të Emelimit të Aksioneve, Administratori harton një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat përcaktuara sipas Ligjit Tregtar në lidhje me të gjitha aksionet e Shoqërisë. Administratori, sipas rastit, hedh të dhënat e aksioneve të emetuara rishtazi sipas Akteve të Emelimit të Aksioneve apo regjistron anulimin e aksioneve. Administratori regjistron gjithashtu në këtë regjistër kalimin aksioneve që i njoftohet nga Aksionari që e kalon aksionin, si dhe çdo veprim e të dhënë tjetër në lidhje me aksionet që mund të kërkohet me ligj apo sipas akteve të Shoqërisë.

(2) Personat e regjistruar në regjistrin e aksioneve prezumohen Aksionarë të Shoqërisë me të drejta të plota si për marrëdhëniet me Shoqërinë, ashtu dhe ndaj të tretëve. Aksionet e të drejtat e fituara mbi to, nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj Shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin aksioneve që mban Shoqëria.

(3) Administratori njofton, herë pas here, dhe brenda afateve të kërkuara, të dhënat e regjistrit të aksioneve të shoqërisë sipas kërkesave ligjore, dhe veçanërisht listën e aksionarëve, pranë QKR në përputhje me Ligjin Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Titujt.

(4) Çdo Aksionar mund ti kërkojë Shoqërisë lëshimin e një vërtetimi mbi të dhënat e tij të regjistrimit në regjistrin e aksioneve të shoqërisë. Në bazë të vendimit të Asamblesë së Aksionarëve, Shoqëria mund të lëshojë certifikata për vërtetimin e zotërimit të Aksionit.

(5) Asambleja e Aksionarëve miraton, ose delegon miratimin nga Këshilli i Administrimit, e rregulloreve të posaçme mbi formatin e regjistrit të aksioneve, të vërtetimeve apo certifikatave të zotërimit të aksioneve, si dhe procedura për kryerjen e regjistrimeve.

## TITULLI IV Asambleja e Përgjithshme

### NENI 17 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve thirret në përputhje me nenin 136, 137, 138 dhe 139 të Ligjit Tregtar nga Këshilli i Administrimit ose aksionarët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar, e në rast urgjence nga çdo anëtar Këshillit apo çdo Administrator, sa herë që e konsiderojnë të arsyeshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë apo sa herë që thirrja e Asamblesë së Aksionarëve është e detyrueshme sipas

Ligjit Tregtar ose dispozitave të tjera ligjore. Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve mund të thirret edhe nga Personat e tjerë të përcaktuar sipas Ligjit Tregtar. Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve duhet të thirret të paktën një herë gjatë një viti financiar për miratimin e bilancit vjetor.

(2) Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë apo me mjete elektronike, në përputhje me aktet e nënshkrimit elektronik, drejtuar çdo Aksionari. Thirrja e Asamblesë së Aksionarëve duhet të njollobet të paktën 21 (njëzetë e një) kalendarike përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat dhe informacionin e përcaktuar në nenin 137 të Ligjit Tregtar. Në rast se mbledhja mbahet me mjete komunikimi, të ndryshme nga prania e njëkohshme e pjesëmarrësve në një vendndodhje të caktuar, përfshi këtu komunikimin me mjete elektronike, Aksionarëve i njoftohen gjithashtu mënyrat e komunikimit dhe të vërtetimit të identitetit e nënshkrimeve (në rastet e komunikimeve elektronike, sipas legjislacionit përkatës për nënshkrimin elektronik).

(3) Aksionarët nuk mund të kërkojë shpalljen e pavlefshmërisë së mbledhjes së Asamblesë për shkak të mungesës së njoftimit, nëse Aksionari i ka dhënë Shoqërisë një adresë të pasaktë (përfshi adresën elektronike) për regjistrim pranë Regjistrimit të Aksioneve, apo nuk i ka njoftuar Këshillit të Administrimit ndryshimin e adresës (përfshirë adresën elektronike) përpara nisjes së njoftimit.

## NENI 18

### Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e Aksionarëve nuk mund të kryejë punime e të marrë asnjë vendim nëse nuk është plotësuar kuorumi i parashikuar në Nenin 144 të Ligjit Tregtar. Aksionarët mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet caktimit të përfaqësuesve, nëpërmjet telekonferencës, audio ose video, si dhe të mjeteve të tjera elektronike në përputhje me Nenin 142 të Ligjit Tregtar (Aksionarët e Pranishëm). Aksionarët që marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike mund të votojnë elektronikisht në mbledhje, pas verifikimit të identitetit të tyre në mënyrë elektronike sipas kërkesave të nënshkrimit elektronik, të përcaktuar në njoftimin e thirrjes.

(2) Kryetari i Këshillit të Administrimit do të kryesojë Asamblenë e Aksionarëve dhe do të caktojë një person si mbajtës të procesverbalit. Aksionarët e Pranishëm me të drejtë vote, me shumicën e thjeshte të votave të zotëruara prej tyre, mund të vendosin që mbledhja të kryesohet nga një person tjetër.

(3) Nëse Kryetari i Këshillit të Administrimit nuk është i pranishëm apo nuk dëshiron të veprojë si Kryetar i Asamblesë, apo nëse asnjë anëtar tjetër i Këshillit të Administrimit nuk është i pranishëm brenda pesëmbëdhjete minutash nga koha e caktuar për nisjen e mbledhjes, Aksionarët e Pranishëm me të drejtë vote, me shumicën e thjeshte të votave të zotëruara prej tyre, do të caktojnë Kryetarin dhe personin që do të mbajë procesverbalin e mbledhjes.

(4) Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratorët kanë të drejtën të marrin pjesë në çdo kohë në mbledhjet e Asamblesë së Aksionarëve, por gjithnjë pa të drejtë vote.

(5) Kryetari, përpara nisjes së punimeve të mbledhjes së Asamblesë së Aksionarëve, verifikon numrin e Aksionarëve të pranishëm personalisht, me mjete elektronike apo

nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, si dhe identitetin e numrin e votave të zotëruara nga secili prej tyre, plotësimin e kuorumit për mbajtjen e mbledhjeve dhe kuorumin e nevojshëm për marrjen e vendimeve sipas rendit të ditës, duke i plotësuar në listën e pjesëmarrësve. Lista e Pjesëmarrësve përmban të dhënat e mësipërme dhe nënshkruhet nga secili pjesëmarrës.

6. Në rastin kur në thërritjen e parë, Kryetari i Asamblesë vërteton se nuk është formuar kuorumi i nevojshëm për mbajtjen e mbledhjes, atëherë ai përsërit njoftimin duke bërë një thërritje të dytë për të njëjtën mbledhje me të njëjtin rend dite, e cila duhet të mbahet jo më vonë se 30 ditë nga mbledhja e parë. Autorizimet e lëshuara për përfaqësimin e një aksionari në mbledhjen, janë të vlefshme dhe për thërritjen e dytë.

## NENI 19 Votat e Aksionarëve

(1) Në varësi të së drejtave ose kufizimeve që lidhen me Aksionet, secili Aksion i zakonshëm mbart të drejtën e 1 (një) vote në mbledhjen e Asamblesë së Aksionarëve. Aksionari mund të përjashtohet nga e Drejta e Votës sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar dhe të këtij Statuti. Aksionarët e Pranishëm detyrohet të votojnë në mënyrë unifikuar për të gjitha aksionet e zotëruara prej tyre.

(2) Vendimet e Jashtëzakonshme të Asamblesë me të cilat vendoset ndryshimi i statutit, zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit, shpërndarja e fitimeve, prishja, ristrukturimi, riorganizimi i shoqërisë, apo çështje të tjera të rëndësishme të lartë të përcaktuara në statut, miratohen me  $\frac{3}{4}$  e votave të aksionarëve pjesëmarrës në mbledhje. Vendimet e Zakonshme të Asamblesë, nëpërmjet të cilave miratohen çështje të tjera, të ndryshme nga ato të përmendura në fjalinë e parë të kësaj pike, merren me shumicë të thjeshtë vote. Neni 145 i Ligjit Tregtar është i zbatueshëm në çështjet e vendimmarrjes.

(3) Vendimet Asamblesë miratohen me votim të hapur nëse përpara deklarimit të rezultatit nuk është kërkuar një votim i fshehtë. Votimin i fshehtë mund të kërkohet nga Aksionarët e Pranishëm që zotërojnë jo më pak se 5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

(4) Nëse nuk kundërshtohet nga një Aksionar, deklarimi i Kryetarit në lidhje me miratimin apo mosmiratimin e një vendimi nga Asambleja e Aksionarëve, si dhe shumica me të cilën është votuar regjistrohet në procesverbalin e mbledhjes dhe konsiderohet vendim i formës së prerë, pa qenë e nevojshme prova për numrin apo përqindjen e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit. Nëse ka kundërshtime, ky fakt shënohet në procesverbal, dhe Kryetari numëron votat pro ose kundër, dhe nëse ka paqartësi, Asambleja voton për herë të dytë çështjen.

(5) Mënyrat e votimit të fshehtë përcaktohen në rregulloren e punimeve të Asamblesë së Përgjithshme. Në rastin e votimit me mjete elektronike, mënyra e votimit duhet të garantojë fshehtësinë e votës.

(6) Të gjitha vendimet e Asamblesë së Aksionarëve regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, mënyrën e mbajtjes së mbledhjes dhe të votimit, rezultatet e votimit, regjistrimin në lidhje me diskutimet e mbledhjes dhe çështjet

e tjera që duhet të shënohen në të sipas Ligjit Tregtar apo rregullores së punimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

(7) Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, autorizimet për votim (nëse ka), si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Në rastin kur mbledhja zhvillohet me mjete elektronike, procesverbalit i bashkëngjiten kopjet e printuara të dokumenteve elektronike që vërtetojnë pjesëmarrjen e nënshkrimit elektronik. Procesverbalit i mbledhjes, lista e pjesëmarrësve e dokumentet e tjera të bashkëlidhura, nënshkruhen nga Kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

(8) Administratorët përgjigjet për ruajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Aksionarëve. Kur procesverbalit përmban të dhëna konfidenciale për aktivitetin e Shoqërisë, mund të nxjerrin ekstrakte.

(9) Administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga mbledhja i njofton Aksionarëve apo përfaqësuesve të tyre kopje të procesverbalit, dhe e publikon atë në një seksion të veçantë të *website* të aksesueshëm vetëm nga Aksionarët.

(10) Nëse mbledhja mbahet nëpërmjet komunikimeve elektronike, ajo konsiderohet e mbajtur në orën dhe vendin e selisë së Shoqërisë.

## NENI 20

### Përfaqësimi në Asamble

(1) Aksionari mund të autorizojë persona të tjerë sipas dispozitave të Ligji Tregtar për ta përfaqësuar atë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Autorizimi bëhet me shkrim. Një aksionar nuk mund të autorizojë persona të ndryshëm që ta përfaqësojnë në lidhje me pjesë të aksioneve të tij.

(2) Autorizimi origjinal me shkrim apo një kopje e noterizuar ose e vërtetuar nga Administratoret apo persona të tjerë të autorizuar, duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë jo më vonë se 24 orë përpara orës së datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Asnjë person nuk do të lejohet të përfaqësojë një aksionar në mbledhjen e Asamblesë nëse autorizimi është depozituar mbas këtij afati.

(3) Autorizimi mund të jepet me mjete elektronike, me kusht që të jepet sipas formatit të përcaktuar në këtë Statut, nënshkrimi të vërtetohet në përputhje me legjislacionin mbi nënshkrimin elektronik dhe autorizimi të dërgohet, jo më vonë se 24 orë përpara orës së datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, nëpërmjet një mesazhi elektronik në adresën e postës elektronike të Shoqërisë që i është njoftuar Aksionarëve.

## TITULLI V

### Administrimi i Shoqërisë

## NENI 21

### Emërimi, Shkarkimi i Këshillit të Administrimit, Kompetencat

(1) Shoqëria do të administrohet sipas sistemit me një nivel, nga një Këshill Administrimi i përbërë nga një numër prej 5 anëtarësh, përbërje që mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Aksionarëve.

(2) Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërohen nga Asambleja e Aksionarëve nëpërmjet një vendimi të zakonshëm, me një afat prej 3 vjet me të drejtë riemërimi.

Këshilli i Administrimit emëron ndërmjet anëtarëve të tij Kryetarin dhe Zv. Kryetarin me shumicë votash. Emërimi ka pasoja ligjore pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Asambleja e Aksionarëve mund të vendose rregulla të tjera në lidhje me emërimin e tyre.

(3) Asambleja e Aksionarëve mund të shkarkojë Anëtarët e Këshilli i Administrimit në çdo kohë me anë të një Vendimi të Zakonshëm.

(4) Këshilli i Administrimit gëzon të drejtat dhe detyrimet që përcaktohen në nenin 154 të Ligjit Tregtar, siç mund të kufizohen nga Asambleja e Aksionarëve.

## **NENI 22** **Administratori**

(1) Këshilli i Administrimit emëron një person fizik si Administrator të Shoqërisë. Administratori emërohet me afat 3-vjeçar. Administratori mund të riemërohet pa limite mandatesh. Emërimi ka pasoja ligjore pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Asambleja e Aksionarëve mund të vendose rregulla në lidhje me emërimin e Administratorëve.

(2) Administratori është përfaqësues ligjor i Shoqërisë, dhe ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet. Këshilli i Administrimit mund të vendosë kufizime në lidhje me tagrat e përfaqësimit të Administratorit për kryerjen e veprimeve të caktuara tregtare dhe/ose veprime me vlerë të caktuar, veçanërisht duke parashikuar miratime paraprake nga Këshilli dhe/ose nënshkrimin e dyfishtë me një anëtar tjetër të Këshillit të Administrimit.

(3) Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.

(4) Këshilli i Administrimit mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë.

## **NENI 23** **Shpërblimi**

Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratori, për punën e tyre përfitojnë shpërblime dhe/ose të ardhura. Pagat dhe shpërblimet dhe të ardhurat e tjera vendosen nga Asambleja e Përgjithshme.

## **NENI 24** **Ekspertët Kontabël, emërimi dhe shpërblimi**

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën për të caktuar një ose disa ekspertë kontabël të zgjedhur nga listat e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Në caktimin e ekspertëve mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara në rregullat e posaçme. Ekspertët kontabël caktohen për një kohë që i përgjigjet një ushtrimi financiar. Ata janë të ri caktueshëm.

Shpërblimi i ekspertëve kontabël të autorizuar caktohet nga asambleja e përgjithshme dhe përballohet nga shoqëria.

## TITULLI VI Dividendët dhe Rezervat

### NENI 25 Dividendët

(1) Me miratimin e pasqyrave financiare të vitit të mëparshëm financiar, nga fitimi i realizuar Shoqëria nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm të Asamblesë së Aksionarëve mund të shpërndajë dividend në favor të Aksionarëve, në përputhje me përqindjen e kapitalit që përfaqësojnë Aksionet e zotëruara prej tyre. Kufizimet e përcaktuara në Ligjin Tregtar për shpërndarjen e dividendit janë të zbatueshme dhe në rastin e Shoqërisë.

(2) Dividendi paguhet në një ose disa këste, duke pasur parasysh nevojat e likuiditetit të Shoqërisë.

### NENI 26 Rezervat

Asambleja e Aksionarëve krijon rezerva sipas përcaktimeve të Ligjit Tregtar, dhe me propozim të Këshillit të Administrimit, mund të krijojë rezerva të posaçme nga fitimet e aktivitetit të Shoqërisë për mbarëvajtjen e aktivitetit të saj.

## TITULLI VII

### Neni 27 Rregulloret, Komitetet dhe Marrëveshjet midis Aksionarëve

(1) Asambleja e Aksionarëve me Vendim të Jashtëzakonshme mund të miratojë rregullore me efekte detyruese, në lidhje me thirrjen, zhvillimin dhe vendimmarrjen në mbledhjet e Asamblesë, përfshi këtu procedurat për llogaritjen e kuorumit e të numërimit të votave sipas Ligjit Tregtar, si dhe për çdo çështje tjetër që konsideron të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë.

(2) Këshilli i Administrimit mund të krijojë Komitete të Posaçme të përbëra nga anëtarët e vet për të përgatitur mbledhjet apo vendimet, ose për të mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të Këshillit.

(3) Këshilli i Administrimit mund të miratojë me vendim unënim rregullore për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve.

(4) Aksionarët mund të lidhin mes tyre marrëveshje për ushtrimin e të drejtës së votës, ndarjen e dividendëve, kalimin e aksioneve apo marrëveshje të tjera që lidhen me ushtrimin e të drejtave e detyrimeve të Aksionarëve në Shoqëri. Shkelja e këtyre marrëveshjeve midis aksionarëve do të përbejë një shkelje të detyrimit të besnikërisë sipas Ligjit Tregtar, duke e detyruar aksionarin mos përmbushjes të dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar, apo të paguajë penalitete të caktuara midis palëve.



**TITULLI VIII**  
**Prishja dhe Likuidimi**

**NENI 28**  
**Prishja dhe Likuidimi**

(1) Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga Ligji Tregtar. Prishja e Shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e afësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi.

(2) Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet procedurës normale ose të thjeshtëzuar, sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.

(3) Likuidimi i Shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e Pjesës përkatëse të Ligjit Tregtar.

**TITULLI XI**  
**Dispozita Finale**

**Neni 29**  
**Emërimi i Organeve të Para të Shoqërisë**

(1) Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë emërohen personat e listuar bashkëngjitur:

(2) Administratori i parë i Shoqërisë emërohet personi i listuar bashkëngjitur:

(3) Auditor(ët) e parë të Shoqërisë emërohen personat e listuar bashkëngjitur:

**Neni 30**  
**Të Ndryshme**

(1) Ky dokument, duke përfshirë Aneksat bashkëngjitur, përbën Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë, dhe zëvendëson çdo dhe të gjitha kontratat, marrëveshjet e mëparshme apo mirëkuptimet, me gojë ose me shkrim, ndërmjet Themeluesve në lidhje me themelimin e Shoqërisë.

(2) Me pranimin e këtij Statuti, asnjë Aksionar nuk do të konsiderohet se ka hequr dorë nga ndonjë prej të drejtave sipas dispozitave të Ligjit Tregtar. Mos kryerja e përpjekjeve nga secili Aksionar për të ushtruar ndonjë dispozite të këtij Statuti apo të drejte që i njihet sipas dispozitave të Ligjit Tregtar, nuk do të interpretohet si heqje dore nga një drejtë e tillë ose nga këto drejta në të ardhmen.

(3) Nëse ndonjë kusht apo dispozite e këtij Statuti shpallet e pavlefshme ose e paligjshme ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera të Statutit, për sa është e mundur nuk do të ndikohen prej kësaj pavlefshmërie. Në këto raste, Asambleja e Aksionarëve do të zëvendësojë pa vonesa dispozitat e pavlefshme, me dispozita të vlefshme, me qëllim përmbushjen e objektit të Shoqërisë.

(4) Nëse midis Aksionarëve apo midis Shoqërisë dhe Aksionarëve do të lindë ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti dhe me ushtrimin e të drejtave të Aksionarëve sipas Ligjit Tregtar ("Mosmarrëveshja"), secila nga Palët në Mosmarrëveshje do t'i japë Palës tjetër në Mosmarrëveshje njoftim me shkrim në lidhje me këtë Mosmarrëveshje, duke parashikuar shkaqet e Mosmarrëveshjes ("Njoftimi i Mosmarrëveshjes"), pas së cilës Palët do të takohen menjëherë dhe do të përpiqen me mirëbesim të arrijnë një zgjidhje me pajtim në përputhje me legjislacionin shqiptar për ndërmjetësimin tregtar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Nëse Mosmarrëveshjet nuk arrihen të zgjidhen me mirëkuptim si më sipër brenda 45 (dyzetë e pesë) Ditëve të Plota nga Njoftimi i Mosmarrëveshjes, atëherë Palët në Mosmarrëveshje mund t'i drejtohen organeve gjyqësore sipas ligjit në fuqi.

(5) Ky Statut nënshkruhet në 4 kopje ne shqip.

(6) Ky Statut do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat e Ligjit Tregtar.

### THEMELUESIT

**"Federata Shqiptare e Futbollit"**  
**Përfaqësues Ligjor**

**Armando DUKA**

**Eduard PRODANI**

**Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë**  
**Përfaqësues Ligjor**

**Ferdinand XHAFERRI**



*Armando Duka*

*Eduard Prodan*

*Ferdinand Xhafferi*

*[Handwritten signature]*

## ANEKSI I

(Themeluesit/Aksionet e nënshkuara/Kontributet)

1. **Organizata Jofitimprurëse "Federata Shqiptare e Futbollit"**, regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 9, datë 31/07/2004, me numër NIPT 162000031, me seli në Tiranë në adresën rruga "Elbasanit", përfaqësuar nga përfaqësuesit ligjor: Presidenti Armando Duka, i biri Enver, lindur në Shijak, më datë 07/10/1962, me adresë Rr. Xhevdet Kallash, Shijak identifikuar me letërnjoftim elektronik 519371659 dhe Sekretari i Përgjithshëm Eduart Prodani, i biri Luan, lindur në TIRANË, më datë 18/06/1963, me adresë Rr. Komuna Perisht, TIR identifikuar me letërnjoftim elektronik 025863670, ortak që zotëron 1.500 aksione me vlerë nominale 1.000 lek secila, për një vlerë të përgjithshme kontributi prej 1.500.000 leke, që përfaqësojnë 75% të kapitalit fillestar, tërësisht të nënshkuara dhe të shlyera në një të katërtën e vlerës totale, përpara regjistrimit të shoqërisë,

1 **2.Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve**, institucion publik, me numër NIPT J91326001G, me seli në Tiranë në adresën Rruga "Kavajës", përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor zoti Ferdinand Xhalëri, i biri i Mynyrit, lindur në Durrës më datë 23.01.1964, me adresë rruga e Kavajës, Tiranë, identifikuar me pasaportën me nr. D 0000409 ortak që zotëron 500 aksione me vlerë nominale **1.000** lek secila, për një vlerë të përgjithshme kontributi prej 500.000 leke, që përfaqësojnë **25 %** të kapitalit fillestar, tërësisht të nënshkuara dhe të shlyera në një të katërtën e vlerës totale, përpara regjistrimit të shoqërisë,



**ANEKSI II**

(Anëtarët e Parë të Këshillit të Administrimit)

Emri/Mbiemri <b>Armand Duka</b>	Data lindja 07/10/1962	Vendlindja SHIRAK	Nënshtetësia Shqiptare	Afati i Emërimit 3 vjet
Lloji i dokumentit Letërnjoftim elektronik	Nr. i Dokumentit 024825619	Ka kufizime në targar e përfaqësimit? Yes/Po <input type="checkbox"/>	Nëse ka kufizime shëno No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>	
Adresa	Rruga Myslym Shyri, Tiranë. Kryetar			

Emri/Mbiemri <b>Eduard Prodani</b>	Data lindja 18/06/1963	Vendlindja TIRANË	Nënshtetësia Shqiptare	Afati i Emërimit 3 vjet
Lloji i dokumentit Kartë Identiteti	Nr. i Dokumentit 025863670	Ka kufizime në targar e përfaqësimit? Yes/Po <input type="checkbox"/>	Nëse ka kufizime shëno No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>	
Adresa	Rr. Komane Parisit, Pall 4/1, Ap 4 Administrator Anëtar			

Emri/Mbiemri <b>Skender Hyka</b>	Data lindja 06/09/1944	Vendlindja TIRANË	Nënshtetësia Shqiptare	Afati i Emërimit 3 vjet
Lloji i dokumentit Passaportë Biometrike	Nr. i Dokumentit 026472731	Ka kufizime në targar e përfaqësimit? Yes/Po <input type="checkbox"/>	Nëse ka kufizime shëno No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>	
Adresa	Rr. Sulejman Pashës, Pëll 124/2, Ap 24 Administrator Anëtar			



Emri/Mbiemri	Data lindja	Vendlindja	Nenshtetësia	Afati i Emërimit
<b>Beshik Cela</b>	05/07/1953	TIRANË	Shqiptare	3 vjet
Lloji i dokumentit	Nr. i Dokumentit	Ka kufizime në tregat e përfaqësimit		
Kartë Identiteti	025168577	Yes/No <input type="checkbox"/>	No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>	Nëse ka kufizime shëno
Adresa	Rr. DIBEEË, P.O. 375/2, Ap 5 Administrator Anëtar			

Emri/Mbiemri	Data lindja	Vendlindja	Nenshtetësia	Afati i Emërimit
<b>Endri Jorgoni</b>	30/04/1978	DURRES	Shqiptare	3 vjet
Lloji i dokumentit	Nr. i Dokumentit	Ka kufizime në tregat e përfaqësimit		
Kartë Identiteti	025023181	Yes/No <input type="checkbox"/>	No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>	Nëse ka kufizime shëno
Adresa (Adresë)	Lagja 7, Rr. Hajdar Durrës, Durrës Administrator Anëtar			

*[Signature]*  
 KOPJE  
 TIRANË

*[Signature]*

**ANEKSI III**  
**(Administrator)**

<b>Famri/Mbiemri</b>	<b>Datëlindja</b>	<b>Nënshtetësia</b>	<b>Alatë i Emërimit</b>
ARIPASH GUCIA	02/09/1969	Shqiptare	3 muaj
<b>Lloji i dokumentit</b>	<b>Nr. i Dokumentit</b>	<b>Ka kufizime në targarë e përfaqësimit</b>	<b>Nëse ka kufizime shëno</b>
Karte identiteti	029530314	Yes/Po <input type="checkbox"/> No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>	
<b>Address (Adresa)</b>	Pn. ARIPASH GUCIA, N.90/10, TIRANË		
Administrator			

*[Handwritten signature]*

*[Official stamp: ARIPASH GUCIA, N.90/10, TIRANË]*

*[Handwritten signature]*

**ANEKSI III**  
**(Auditorët e Parë)**

Ekspert Kontabël i Autorizuar	Dokumenti i Identifikimit	Autoriteti Licenses	Data e Licensës	Numri i Licensës /
 Bertë Pasiko	027142497	IEKA	10.02.2000	7

*Holly & Endri Auditim*





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Notere MAJLINDA E.DEMOLLARI

Nr. 1482 Rep.  
Nri 832 Kol.



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 26.03.2011 (dymije e njemebdhjete), para meje Noteres Publike Majlinda E.Demollari, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht :

Federata Shqiptare e Futbollit oerfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor;

- Armando Duka i datelindjes 07.10.1962, lindur ne Durres dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pashaporte me nr. S19371659
- Eduard Prodani, i datelindjes 18.06.1963, lindur dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin ID 025863670.

Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise perfaqesuar nga Ministri Ferdinand Xhaferrri, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i njohur personalisht prej lij.

Me vullnetin e tyre te lire e te plote kane redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, me cilesine e aksionereve te shoqerise" QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sha, Akt-themelimin e statutin drejtuar QKR, per regjistrimin si person juridik te kesaj shoqerie tregtare dhe pasi e lexoj ate e nenshkruajne pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale te tyre ne kete zyre dhe para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj tregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj te kesaj kerkese si dhe autenticitetin e nenskrimeve, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.

NO T E R E



Noterja e Noteres Publike  
Majlinda E. Demollari  
Tirane, 26.03.2011